



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 3211 /2022
Dt: 22.11.2022

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, neni 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe neni 4,5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Skenderaj, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Pozita: Punëtor teknik

1. Punëtor/e teknik – në gjimnazin “ Hamëz Jashari “ - Skenderaj
2. Punëtor/e teknik – në shfmu “ Ismet Uka “ - Ticë

Koeficienti : **4.0**

Lloji i vendit të punës: **me orar të plotë**

Numri i pozitave: **dy (2) ekzekutues**

Detyrat kryesore të punës :

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajë dhe pastrojë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës.
- Të ruajë mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes.
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës.
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe, sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të mbaruar Shkollën e Mesme të Lartë
- Përvoja e punës (nëse posedon)

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni
- Diploma e shkollimit të mesme të lartë
- Certifikatën që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimin (kopje)

Konkursi në web-faqen e komunës hapet nga data **22.11.2022** deri me datën **06.12.2022**, afati i konkursit mbetet i hapur **15** ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr.13.

